



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM



Dt. 13.07.2018, Nr. 09-111-40589

Në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 06/2015 të dt. 10/07/2015 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtori për Arsim, shpallë:

K O N K U R S

1. SHML. GJIMNAZI „ GJ. K. SKËNDERBEU “ në Drenas

- Një mësimdhënës për gjuhë angleze
- Katër mësimdhënës për matematikë.

2. SHMP. „ FEHMI LLADROVCI “ në Drenas

- Pesë mësimdhënës për gjuhë angleze.
- Shtatë mësimdhënës për matematikë
- Një mësimdhënës për dizajn

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.06 / 2015.

P.S: Të gjithë kandidatet të cilët nuk janë me përgatitje adekuate, sipas udhëzimit administrativ të lartcekur, nuk do të shqyrtohen aplikacionet e tyre, përjashtimisht në mungesë të kandidateve më kualifikim përkatës do të shqyrtohen aplikacionet më kualifikim më të përafërt.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Diploma origjinal ose e vërtetuar në Komunë - Noteri publik.
3. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më të vjetër së gjashtë muaj.
4. Vërtetim apo Çertifikatë origjinale e përvojës së punës, e vërtetuar në Komunë - Noteri publik, vetëm në arsim.
5. Çertifikatë mjekësore për gjëndjen shëndetsore lidhur me çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.
6. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim ose patentë shoferi)
7. Kopje të Çertifikatave të trajnimeve përkatëse (nëse keni)

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim dhe më gojë dhe përzgjedhjen e kandidateve do të bëjë Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurrim merret në zyrat e DKA-së, G-11, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas:13.07.2018.



Drejtör për Arsim
Tafil Halilaj